

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Luan Berisha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Naxhis Sharani, procesmbajtëse, në lëndën penale kundër të akuzuarit Sh. I., nga Prizreni, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën paragrafi 1.1 të KP-ës, sipas aktakuzës të Prokurorisë themelore në Prizren PP.nr.3531/2015 të datës 30.03.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor në praninë e Prokurorit të shtetit në Prizren Zejnullah Gashi, të akuzuarit, si dhe të dëmtuarit M. A., me datën 20.04.2017 publikisht morri dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

SH. I., nga i ati I. dhe nëna Z. e lindur R., i lindur me datë *data e lindjes...*, në D., tani jeton në Prizren, rruga ..., nr...., ka të kryer shkollën fillore, taksistë, i shkurorëzuar, baba i tre fëmijëve, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së varfër ekonomike.

ËSHTË FAJTOR

Se me datën 04.11.2015, rreth orës 14,30 minuta, në Prizren rruga ...i shkakton lëndime të lehta trupore të dëmtuarit M. A., të cilat lëndime rezultojnë me dëmtime të përkohshëm ose dobësim të një organi në pjesë e trupit të personit tjetër, për shkak të kontestit gjyqësor ndërmjet të pandehurit dhe të dëmtuarit, në atë mënyrë që ditën kritike, derisa i dëmtuari M. A. ishte duke shkuar në “Xhami”, në atë momente ishte takuar me të pandehurin Sh. I., i cili fillimisht i ‘u është përgjigjur me fjalët “Parat e kredisë kur ke me mi kthy”, gjersa i dëmtuari i ‘u është përgjigjur me fjalët “Rasti është në gjykatë, le të vendos gjykata”, dhe me atë rast i pandehuri e kishte sulmuar fizikisht të dëmtuarin M. A., duke e goditur me grusht në fytyrë, me ç’ rast të dëmtuarit M. A. i shkakton lëndime të lehta trupore, lëndime këto të përshkruara më për së afërmi në mendimin e ekspertit mjeko – ligjor dr. N. U., të datës 13.03.2016,

Këso dore ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 nën paragrafi 1.4 të KP-ës.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 7,41,49 par.1 pika 1.1,50,51,52,73,74,75, dhe 188 par.3 lidhur me nën par.3.1 të KP-së, të akuzuarës i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Vërteton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin prej 2 (dy) viteve nga dita e plotëfuqishëmrisë të këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale,

Obligohet i akuzuari të paguaj shpenzimet e procedurës gjyqësore dhe ate në emër të ekspertizës mjeko ligjore shumë prej 20,00 euro, dhe shpenzimet e paushallit gjyqësor në

shumën prej 20,00 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmrisë të këtij aktgjykimi, nën kërcnim të ekzekutimit të dhunshëm.

I dëmtuari: M. (R.) A., nga Prizreni, rruga ..., pa numër, për realizimin e kërkesës pronësore juridike udhëzohen në kontestin e rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën PP.nr.3531/2015 të datës 30.03.2016, kundër të akuzuarit Sh. I., nga fshati P., për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën par.1.1 të KP-ës.

Prokurori i shtetit Zejnullah Gashi, në fjalën e tij përfundimtare deklaroi: qëndroj në tërësi pranë aktakuzës PP.nr.3531/2015 të datës 30.03.2016, kundër të akuzuarit Sh. I. për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën par.1.1 të KP-ës, e tërë kjo bazohet nga provat materiale dhe ate raportit mjekësor të emergjencës të spitalit rajonal në Prizren, me numër të protokollit 4403 të datës 04.11.2015, si dhe në bazë të ekspertizës mjeko ligjore të datës 13.03.2016, e po ashtu edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe administrimit të provave me dëgjimin e dëshmitarit F. S., si dhe të vetë të dëmtuarit, e po ashtu edhe pjesërisht nga deklaratat e vet të akuzuarit, vërteton pa asnjë dyshim se këtu i akuzuari në ditën kritike, kohën dhe vendin si në dispozitiv të aktakuzës ka ndërmarrë veprime me të cilat veprime edhe ka kryer veprën penale lëndimi i lehtë trupor në atë mënyrë që me grusht e ka goditur këtu të dëmtuarin M. A..

Sa i përket mbrojtjes së të akuzuarit se motiv i kësaj vepre është një lloj borxhi që i akuzuari pretendon që i ka i dëmtuari ndaj tij, kjo nuk e përjashton përgjegjësin e të akuzuarit, e aq më tepër se ka kundërthënë nga deklaratat e dhëna në polici, gjatë shqyrtimit gjyqësor, si dhe padinë e ushtruar nga ana e të akuzuarit në cilësinë e paditësit në kontest civil.

Andaj kjo është sipas mendimit tonë qëllimi vetëm shmangia nga përgjegjësia penale dhe vënia në lajthim të gjykatës.

Andaj përkitazi me të cekurat kërkoj nga gjykata që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit. Me rastin e marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata të marr parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese për të akuzuarin. Si rrethanë lehtësuese të marr parasysh peshën e veprës penale për shkak të lëndimeve të pësuarat të dëmtuarit të cilat lëndime janë të karakterit të lehtë trupor, ndërsa si rrethanë rënduese të marr parasysh se i njëjti është recidivist duke u bazuar edhe në aktgjykimin e plot fuqishëm të kësaj gjykate P.nr.399/2013 të datës 08.09.2014, i plotfuqishëm me datën 11.12.2014, ku si i dëmtuar është po ashtu këtu i dëmtuari i njëjti.

I dëmtuari M. A., në fjalën e tij përfundimtare deklaroi, në tërësi e përkrah dhe e mbështes fjalën përfundimtare të prokurorit të shtetit, duke shtuar që si palë e dëmtuar parashtroj

kërkesë pronësoro juridike, për lartësinë e të cilës shumë do të sqarohem në kontest të rregullt civil.

I akuzuari Sh. I., në fjalën e tij përfundimtare deklaroi: në tërësi si në shqyrtimin fillestar, në fjalën hyrëse, në mbrojtjen time dhe tani në fjalën përfundimtare deklaroi që unë me asnjë veprim nuk kam shkaktuar veprën penale e cila më vihet në barë. Në ditën, kohën dhe vendin të përshkruar si në aktakuzë, unë kam shkuar të takohem me M. në mënyrë të qetë, i kam kërkuar borxhin, të cilin borxh i dëmtuari nuk e ka pranuar, andaj pas refuzimit të tij, ne jemi larguar, unë nuk e kam goditur M., unë në ditën kritike kam qenë vetëm vetëm, dhe kam qenë me automjetin tim, andaj nuk e di se kur dhe kush i ka shkaktuar këto lëndime të dëmtuarit. Konsideroj që nga të cekurat më lart nuk është vërtetuar që unë kam kryer veprën penale e cila më vihet në barë, andaj propozoj nga gjykata që të më liroj nga kjo akuzë.

Gjykata në shqyrtimin kryesor ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Se me datën 04.11.2015, rreth orës 14.30

Gjykata pas vlerësimit të gjitha shkresave dhe provave të lëndës dhe ate deklaratave të dëmtuarit, të akuzuarit, si dhe dëshmitarit F. S., si dhe provave materiale dhe atë raporti mjekësor i emergjencës të spitalit rajonal në Prizren me numër të protokollit 4403 të datës 04.11.2015 në emër të dëmtuarit M. A., ekspertiza mjeko ligjore e ekspertit N. U. të datës 13.02.2016, aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren P.nr.339/2012 të datës 08.09.2014, i plotfuqishëm me datë 11.12.2014, si dhe në bazë shkresave tjera përcjellëse të lëndës, ka ardhur në përfundim se e akuzuari me datë 04.11.2015, rreth orës 14.30 minuta, në Prizren, në rrugën ..., i ka shkaktuar lëndime trupore të dëmtuarit, duke e goditur me grusht në fytyrë, dhe këtë veprim i akuzuari e ka kryer me dashje sepse ka qenë i vetëdijshëm për veprimet e veta dhe ka dëshiruar kryerjen e saj. Pra në rastin konkret gjykata në këtë mënyrë edhe ka vërtetuar përgjegjësin e tij penal juridike, nga kjo del që në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën par.1.1 të KP-ës.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga deklaratat e të dëmtuarit M. A., i cili në shqyrtimin gjyqësor me datë 22.03.2017, deklaroi: me datën kritike me datë 04.11.2015, kam qenë në xhami për ta falur namazin e iqindisë. I akuzuari ka qenë me automjetin e tij, së bashku me një person tjetër për mua të pa njohur, i akuzuari e ndaloi automjetin, dhe më kërkoi borxhin, unë i sqarova që pasi që lënda është në gjykatë, dhe derisa kam qenë duke folur, i njëjti më ka goditur, nuk mund të sqarohem se me çka më ka goditur, ngase unë nga këto të goditura e kam humbur vetë dijen. I akuzuari më ka kërkuar një kompensim si borxh në emër të një garantuesi që kam qenë gjatë marrjes së një kredie. Tek mjeku më ka dërguar bashkëshortja ime, e cila më dërgoi së bashku nga shtëpia për në Stacion policor, pasi që unë u ktheva në shtëpi pasi që më goditi këtu i akuzuari. Prej stacionit policor e deri në spital për ndihmë të parë emergjente, kam shkuar vetë. Më ka goditur në pjesën e faqes së majtë, një goditje si theksova më lartë nuk e di se me çka dhe si, dhe menjëherë është futur në automjet dhe është larguar nga vendi i ngjarjes. Jo nuk kam pasur borxhe të mëhershme këtu të akuzuarit. Me të akuzuarin nuk kam kurrfarë raporte as familjare e as shoqërore e as farefisnore, i njëjti vetëm është bashkëvendasi i imi, pasi që jemi të njëjtit fshati dhe ate të fshatit B., Komuna e D.. Kam pasur probleme dhe mosmarrëveshje me të akuzuarin, të cilat kanë qenë që nga viti 2008.

Në shqyrtimin gjyqësor me datë 20.04.2017, dëshmitari F. S., deklaron: me datë 04.11.2015, kam qenë në shtëpinë e të dëmtuarit dhe e kam kërkuar, për të ma rregulluar instalimin elektrik, në shtëpinë time ku jetoj. Është e vërtet, që më ka kërkuar ti lë kohë për të shkuar deri në xhami për ta falur namazin e iqindisë, dhe par përfundimit të këtij rituali do të vijë i dëmtuari te unë, jemi nisur nga shtëpia e të dëmtuarit për në xhami, ndërsa unë kam dashur të vazhdoj rrugën për në shtëpinë time, i dëmtuari u nis për në xhami, ndërsa unë tentoja ta largoja nipin e të dëmtuarit 5-6 vjeçar, i cili dëshironte të shkonte pas tij, kam tentuar që të njëjtin ta bind që të lejoj të shkoj në xhami, duke u ballafaquar me nipin e këtui të dëmtuarit, për ta larguar nga ndjekja e të dëmtuarit, gjatë kësaj kohe e kam vërejtur që këtui akuzuari emrin e të cilit nuk e kam ditur, por sot po e shoh këtui në gjykatë, i cili e ka goditur këtui të dëmtuarin me grusht në pjesën e fytyrës, dua të theksoj që paraprakisht kamë dëgjuar edhe fjalët e të akuzuarit drejtuar të dëmtuarit “ku je edepsëz”, dhe pas kësaj e ka goditur ashtu siç përshkrova më lart, kam vërejtur konkretisht që e ka goditur me një grusht, dhe pas goditjes i akuzuari ka hyrë në automjetin e vet dhe është larguar nga vendi i ngjarjes, duke u larguar i akuzuari nga vendi i ngjarjes, unë vrapova në drejtim të tij, për të kërkuar sqarim se cila ka qenë arsyeja pse e goditi këtui i akuzuari të dëmtuarin, por të njëjtin nuk arrita ta kontaktoj, pasi siç thashë më lartë u largua me automjetin e vet.

Pasi që nuk arrita të kontaktoj me të akuzuarin, u ktheva tek i dëmtuari M., për të shikuar se si është, por në ndërkohë ishin mbledhur një grupi njerëzve, dhe unë me të vërejtur këtë, shkova në shtëpinë time. Unë pasi që e vërejtja grupin e njerëzve, nuk kontaktova fare me M., dhe i njëjti çka ka bërë më tutje unë nuk e di, ngase unë shkova në shtëpinë time.

Pas goditjes, i dëmtuari është mbështetur për një murri që ka qenë aty pranë tij, dhe se në ndërkohë deri sa unë vrapova pas të akuzuarit, nga mbështetja në murr, i dëmtuari nuk mund të qëndronte dhe u rrezua në tokë. Lloji i automjetit të akuzuarit në momentin e largimit nuk më kujtohet, gjegjësisht nuk kam mundur ta vërej, vetëm e di që automjeti ka qenë i ngjyrës së bardhë, dhe kur i akuzuari ka hyrë në automjet, në automjet ka qenë duke e pritur edhe një person tjetër i cili ka qenë i ulur në karrikën e përparme afër shoferit.

Hera e parë kur e kam parë të akuzuarin ka qenë në ditën, kohën dhe vendin ku e ka goditur të dëmtuarin. Më herët nuk e kam njohur. Të dëmtuarin M. A.. e njoh si mjeshtër të instalimit elektrik, ngase i njëjti më herët e ka rregulluar instalimin elektrik të një fqit tim.

Në shqyrtimin gjyqësor me datë 20.04.2017, janë administruar provat dhe ate raporti mjekësor i emergjencës të spitalit rajonal në Prizren me numër të protokollit 4403 të datës 04.11.2015 në emër të dëmtuarit M. A., ekspertiza mjeko ligjore e ekspertit N. U. të datës 13.02.2016. aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren P.nr.339/2012 të datës 08.09.2014, i plotfuqishëm me datë 11.12.2014.

Në shqyrtimin gjyqësor me datë 20.04.2017, i akuzuari Sh. I., në mbrojtjen e vet deklaron: Me këtui të dëmtuarin M. A.. jemi bashkë fshatar, të dytë jemi nga fshati B. Komuna e D., raportet në mes veti i kemi pasur shumë të mira, por që nga viti 2008 raportet tona janë keqësuar nga arsyeja që këtui i dëmtuari më ka borxh një shumë të hollave diku rreth 2.000 Euro, e po ashtu i njëjti në këtë periudhë e ka marr kartonin e pensionit të babait tim, i cili ka punuar në

Republikën e Sërbisë për të tërhequr pensionin nga një bankë në Serbi, por i dëmtuari as nuk më ka sjell pensionin e babait, e as nuk ma ka kthyer kartonin e pensionistit të babait tim, andaj nga këto të cekurat, raportet tona kanë filluar të acarohen, dhe po ashtu lidhur me këtë unë jam drejtuar edhe gjykatës në kontest civil, mirëpo nga e njëjta më është refuzuar kërkesë padia, unë një kohë të gjatë i kërkoj borxhin këtu të dëmtuarit, por i njëjti në asnjë mënyrë nuk e pranon borxhin që e ka ndaj meje.

E vërtetë është se me datë 04.11.2015 rreth orës 14,30 në Prizren në rrugën jam takuar me këtu të dëmtuarin M. A.. Kam qenë unë vetë dhe M. vet. Në vend të ngjarjes kam shkuar me automjetin tim të markës “Ford Escord 1.4”, ngjyrë e bardhë, edhe një herë po e përsërisë kam qenë vetëm. Si theksova në fillim, i kam kërkuar borxhin e lartë cekur, dhe i njëjti përsëri refuzoi të më kthej borxhin, duke më thënë nëse donë ta vërtetosh mund ta vërtetosh vetëm me gjykatë, dhe në rast se gjykata vërteton që të kam borxh do ta paguaj, dhe pas kësaj bisede ne jemi larguar në mënyrë të qetë dhe unë kam vazhduar në drejtimin tim ndërsa i dëmtuari në drejtimin e vet. Jo nuk e kam goditur me grusht

I akuzuari me rastin e bullafaqimit mes deklaratës të dhënë në polici dhe në shqyrtimin gjyqësor rreth të vërtetës të borxhit që i akuzuari pretendon që ja ka i dëmtuari, e vërteta është deklarata e dhënë në polici, ndërsa sot që deklarova 2.000 Euro, kam llogaritur edhe borxhet tjera që pretendoj që mi ka borxh këtu i dëmtuari. Nuk e kam paraqitur edhe shumën prej 2.000 euro në Stacionin policor në Prizren, nuk i kam deklaruar, nuk e di se pse, faji është i imi.

Shuma e borxhit për të cilin unë kam bërë padi në kontest civil pranë kësaj gjykate kundër të paditurit këtu të dëmtuarit M. A., është shuma prej 327 euro, kërkesë padi e cila më është refuzuar nga ana e kësaj gjykate me aktgjykimin Cnr.181/14 të datës 17.12.2015, i plotfuqishëm me datën 11.03.2016, Shuma e cekur sot në mbrojtjen time është shumë e cila është krijuar nga disa borxhe tjera në formë të garantimit nga ana e të dëmtuarit, në raportet kreditore në mes meje dhe A. O., andaj pasi që i njëjti nuk ka përmbushur këto debitë të konstatuara gojarisht me marrëveshje siç jemi marr vesh paraprakisht, andaj nga të cekurat edhe në total i njëjti konsideroj që më ka borxh shumën diku rreth 2.000 Euro. Unë kam garantuar me anë të nënës sime për tërheqjen e kredisë të A. O. në shumë prej 11.100 Euro, dhe si kompensim për këtë garant unë kam pasur për ti marr shumën prej 1.250 Euro të cilën shumë ka qenë garantues këtu i dëmtuari M., i cili ka ndërmjetësuar në këtë raport. Këtë shumë e kam caktuar si kompensim për arsyen se këtu i dëmtuari M. A. së bashku me A. O., më kanë garantuar mua që do të tërheqin pensionet e babait tim në bankat e Sërbisë, por siç theksova edhe më lart, pensionet nuk arritën ti tërheqim, dhe po ashtu edhe kartonin e pensionit të babait tim që unë i kam dhënë M. më nuk më është kthyer., andaj për këtë unë kam kërkuar një lloj kompensimi, ky kompensim ka qenë në bazë të marrëveshjes gojore, me këtu të dëmtuarin. Andaj për këtë unë në bazë të ndërmjetësimit të M. kam hyrë nëpërmjet nënës sime si garant për kredinë e A. O., me të cilën kredi do të kompensojsha në shumën prej 1.250 Euro, në emër të kompensimit për mos tërheqjen e pensionit, andaj për këtë unë në bazë të marrëveshjes me të dëmtuarin M, kam kërkuar nga ai këtë shumë, pasi që A. O., nuk ka qenë pjesë e marrëveshjes sonë, andaj për këtë edhe në total shuma e borxheve që pretendoj që mi ka këtu i dëmtuari M. është diku rreth 2.000 euro.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar në bazë të deklaratës të dëmtuarit i cili në shqyrtimin gjyqësor thekson se në ditën kritike ka qenë duke shkuar në xhami për ta falur ritualin e iqindis dhe e ka takuar këtu i akuzuari i cili paraprakisht ja ka kërkuar një borh të pretenduar që ja ka sipas tij këtu i dëmtuari dhe pasi që i njëjti refuzoi pranimin e borxhit, i akuzuari e goditi në pjesën e fytyrës dhe me këtë rast i shkaktoi lëndime trupore, si dhe deklaratës të dëshmitarit – F. S., të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor, të cilat deklarata në tërësi janë identike, të përputhshme në mes veti, dhe se në këtë mënyrë vërtetohet edhe gjendja faktike e përshkruar në dispozitiv të aktaluzës, si dhe i akuzuari pas goditjes të dëmtuarit u largua me automjetin e tij nga vendi i ngjarjes, në drejtim të panjohur për çka gjykata në mënyrë të plotë ja ka falur besimin këtyre deklaratave. Deklaratat e cekura janë në përputhje të plotë edhe me provat materiale të administruara dhe ate raporti mjekësor i emergjencës të spitalit rajonal në Prizren me numër të protokollit 4403 të datës 04.11.2015 në emër të dëmtuarit M. A., ekspertiza mjeko ligjore e ekspertit N. U. të datës 13.02.2016, me anë të cilave vërtetohen edhe shkalla dhe lëndimet e pësura të dëmtuarit nga veprimet e përshkruara më lartë të akuzuarit, Pretendimet e të akuzuarit të dhëna në mbrojtjen e vet, se nuk e ka goditur të dëmtuarin, por vetëm i ka kërkuar borxhin që pretendon i akuzuari që i ka i dëmtuari, dhe se gjatë tërë mbrojtjes së tij i njëjti më shumë është orientuar në drejtim të borxhit se sa në drejtim të objektit të kësaj çështje penale. Gjykata nuk e ka marr për bazë arsyen, shkakun dhe motivin që i akuzuari deklaronte për këtë çështje penale dhe pse ka ardhur deri te kjo, aq më tepër gjykata nuk ja fali besimin mbrojtjes të tillë të akuzuarit, pasi që i njëjti deklaroi në vijim që fare nuk e ka goditur të dëmtuarin, por i njëjti nuk ofroi dhe nuk parashtrori asnjë provë bindëse për të vërtetuar pafajësin e vet, andaj gjykata nuk ja fali fare besimin, nga shkakun që ka për qëllim vetëm shmangien dhe përjashtimin e përgjegjësisë nga përgjegjësia penale e të akuzuarit dhe lirimin e të njëjtit nga akuza, Gjykata poashtu e shqyrtoi edhe deklaratën e të akuzuarit lidhur me borxhin e të dëmtuarit ndaj të akuzuarit, ashtu siç deklaroi i akuzuari në pjesën më të madhe të deklaratës të vet, por lidhur me këtë gjykata konsideron se edhe po të ekzistonte borxhi siç pretendon i akuzuari atëherë një raport i tillë në mes të akuzuarit dhe të dëmtuarit do të ishte raport civilo-juridik, për çka i akuzuari edhe e ka parashtruar padin në kontestin civil, e aq më shumë askujt nuk i ipet e drejt që tjetrit ti shkaktoj lëndime trupore, pa marrë parasysh shkakun, motivin apo arsyen, ngase veprimet e tilla që shkaktojnë lëndime trupore dhe si të tilla paraqesin edhe vepër penale, por sipas mendimit dhe konstatimit të gjykatës deklarata e të akuzuarit në mbrojtjen e vet në këtë drejtim nuk e përjashton përgjegjësin e tij penale juridike në këtë çështje penale. Nga të cekurat gjykata ka ardhur në përfundim që është e vërtet që i akuzuari në ditën, kohën dhe vendim të përshkruar më gjerësisht në dispozitiv të aktgjykimit, e ka goditur të dëmtuarin me grusht duke i shkaktuar edhe lëndime trupore, andaj në këtë mënyrë gjykata edhe ka vërtetuar që i akuzuari këtë veprim e ka kryer me dashje sepse ka qenë i vetëdijshëm për veprimet e veta, andaj gjykata ka ardhur në përfundim që në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet qenësore të veprës penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin të shpall fajtorë dhe ta gjykojë në bazë të ligjit duke vërtetuar përgjegjësin e tij penal juridike.

Me rastin e marrjes së vendimit ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KP-ës të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, si rrethanat rënduese është marrë fakti që i akuzuari është përsëritës i veprave penale, ngase i njëjti edhe në bazë të aktgjykimit të kësaj gjykate P.nr.339/2012 të datës 08.09.2014, i plotfuqishëm me datë 11.12.2014. është shpallur fajtor dhe është dënuar, ku si i dëmtuar poashtu është këtu i dëmtuari, Milaim Alija, e që si rrethanë lehtësuese është marrë sjellja korrekte pas

kryerjes së veprës penale, konform nenit 74 gjykata mori si rrethanë lehtësuese rrethanat personale edhe karakterin e personit të dënuar, moshën e të njëjtit, bashkëpunimin e përgjithshëm të personit të gjykuar me gjykatën, bashkëpunimin vullnetar të personit të dënuar në hetimin dhe ndjekjen penale, moshën e të akuzuarit në momentin e kryerjes së veprës penale, është person familjar, baba i tre fëmijëve, sjellja e tij pas konfliktit, andaj gjykata i shqiptoi dënimin me gjobë në shumë prej 300 (treqind) euro, duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jetë më i kujdesshëm dhe do të përmbahet nga veprimet e tilla.

Vendimin mbi udhëzimin e të dëmtuarës në kontest të rregullt civil gjykata e bazoi në kuptim të nenit 463 të par.1 dhe 2 të KPP.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës dhe të paushallit gjyqësor gjykata e bazoi në kuptim të nenit 450 par.1 dhe 2 pika 2.6 dhe 451 par.1 të KPP.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.682/2016 me datë 20.04.2017

Procesmbajtësja
Naxhis Sharani

Gjyqtari
Luan Berisha

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtës, Gjykatës së apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.